



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 27 mars 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U vendos miratimi i kërkesës së shoqërisë “Trans Adriatic Pipeline AG” (TAP AG) për ndryshimin e “Rregullores së Lidhjeve të Reja në Sektorin e Gazit Natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 14.11.2019.

U vendos miratimi i riemërimit në detyrë i Zyrtarit të Pajtueshmërisë, të propozuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes “OSSH” sh.a.

Në çështje të tjera, Bordi miratoi planet e punës për vitin 2026, si dhe Raportin Vjetor të ERE-s “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2025”.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.